



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nën paragrafi d) nën 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nën 30 të Ligjit Nr.03/L-448 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nën 16 të Ligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nën 40 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me rekomandimet e KPF të dt.16.07.2018, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 31.07.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Transfer/rialokim të mjeteve për projekte kapitale nga buxheti i vitit 2018

- I. Miratohet vendimi për transfer/rialokim të mjeteve për projekte kapitale nga buxheti i vitit 2018.
- II. Transferi behët tek kategoria ekonomike-shpenzimet kapitale, në një projekt tjetër bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 nr.06/L-020, me qëllim të rregullimit të ndarjeve buxhetore brenda programeve komunale.
- III. Në kategorinë ekonomike - shpenzime kapitale- në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, shuma prej 50.000.00€ nga Projekti "Sinjalizimi i rrugëve" me kod të projektit 44870 të transferohet në Projektin "Mirëmbajtja e rrugëve", me kod të projektit 43798 në të njëjtën Drejtori me arsyetimin së për sinjalizimin dhe emërimin të rrugëve është siguruar donacioni gjë që shuma e mjeteve të planifikuara për këtë projekt mbetet e panevojshme.
- IV. Në kategorinë ekonomike –shpenzime kapitale- në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shuma prej 60.000.00€ nga Projekti "Ujësjiellësi në Fshatin Çabiq" me kod të projektit 43808 të transferohet në Projektin "Asfaltimi i rrugëve lokale në Çabiq" me kod të projektit 47244 në të njëjtën drejtori me arsyetimin së përfaqësuesit e lagjeve kanë kërkuar që mjetet e dedikuara për ujësjiellës të dedikohen për rrugë me të cilën është pajtuar edhe Ekzekutivi i Komunës.
- V. Vendimi miratohet më kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe implementimet po nga kjo Drejtori.

- VI. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës, kjo në kuptim të nenit 15,16 dhe 17 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/2017 , të dt.23.08.2017 për Procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës .
- VII. Me këtë Vendim njoftohen: MAPL,MF Kryetari i Komunës, Drejtoria FEZH, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 060-5173 2018
Klinë, më 01.08. 2018

Kryesuesi,
Fadil Gashi

